VENDIM
Nr.575, datë 28.5.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS REMAS TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Remas të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 314 (treqind e katërmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Remas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Remas Lidhja nr.1

Numrat rendor të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
2-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
17-23	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore sportive	Në pronësi
30-41	Shërbim funeral	Në pronësi
26-29,254-257,261-275	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në pronësi
236-238	Prona që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm	Në pronësi
276-278	Prona që përdoren në fushën e ndriçmit publik	Në pronësi
89-97	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
24,25,44,51,301,302	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës	Në pronësi
239,247	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
311-313	Pyje shkurre	Në pronësi
139,153,171,176,183,240-246, 248-250,303-305,306-310,314	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive, kanale të treta)	Në pronësi